



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 155, datë 15.05.2020

PËR

ZGJATJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË PËRKOZHSHËM PËR HARTIMIN E NJË PLANI VEPRIMESH LIDHUR ME REDUKTIMIN E ÇËSHTJEVE TË PRAPAMBETURA DHE RITJEN E EFIKASITETIT NË GJYKATËN E LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke u bazuar në nenet 62/14 dhe 89 të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.126, datë 19.07.2019, nr.317, datë 19.12.2019, dhe nr.131, datë 30.03.2020, të ndryshuar me vendimin nr.147, datë 28.04.2020 si dhe në Memorandumin e Mirëkuptimit të nëshkruar nga palët pjesëmarrëse, me propozim të Komisionit të Përkohshëm për Hartimin e një Plani Veprimesh Lidhur me Reduktimin e Çështjeve të Prapambetura dhe Rritjen e Efikasitetit në Gjykatën e Lartë,

V E N D O S I:

1. Zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Përkohshëm për Hartimin e një Plani Veprimesh, lidhur me Reduktimin e Çështjeve të Prapambetura dhe Rritjen e Efikasitetit në Gjykatën e Lartë (Komisioni), i ngritur me vendimin nr.317, datë 19.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Objekt i veprimtarisë së këtij Komisioni do të jetë edhe mbikëqyrja dhe zbatimi i Memorandumit të Mirëkuptimit, i nëshkruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar.
3. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Komisionit, sipas pikës 2 të këtij vendimi, do të jetë pa afat, deri në përmbushjen e plotë të angazhimeve të marra nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe për aq kohë sa do të jetë në fuqi ky Memorandum Mirëkuptimi.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi kryetari dhe anëtarët e Komisionit të Përkohshëm.
5. Në përmbushjen e detyrave të tij, Komisioni do të mbështetet nga personeli administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR